

PKR.nr.473/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtarja, Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues, me procesmbajtësen Arbnore Idrizi, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale, kundër të akuzuarit B. I., për shkak të veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të rënda, PP.I.nr.17/16, të datës 12.08.2016, në seancën e shqyrtimit fillestar të hapur, të mbajtur me dt.**25.04.2017**, në praninë e prokurorit të shtetit, Arian Gashi dhe të akuzuarit B. I., në bazë të nenit 366 të KPPK-së, të njëjtën ditë mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **B. I.**, nga i ati I. dhe nënës M., e vajzërisë B., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin K. Komuna e G., ku edhe tani jeton, me numër personal *numer personal...*, ka të kryer Fakultetin Filozofik-drejtimi historik dhe vazhdon studimet në master, me profesion arsimtar i historisë, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Më dt.21.12.2015, rreth orës 00:10 në afërsi të depos së Marketit “...” pronë e të dëmtuarit Z. H. në fshatin K., K. e G., i akuzuari pa autorizim ka përdorur armën, në atë mënyrë që ka shtënë një herë në ajër në drejtim të kamerës së market “Sh.” dhe pas një kontrolli nga ana e Policisë së Kosovës, i janë gjetur dhe sekuestruar arma, 4 fishek të kal. 16mm, një qese plastike 24 fishekë të kal. 15mm, 5 fishek të armës automatike të kal 7.62 mm, një fishek të pushkës M48 si dhe një fishekë të pistoletës me gaz, të cilat i mbante pa autorizim,-

-me këtë ka kryer veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së

II. Me datë kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitën e parë të këtij aktgjykimi, i akuzuari me qëllim ka dëmtuar pasurinë e luajtshme të personit tjetër, në atë mënyrë që derisa ka shtënë me armë në ajër, ka qëlluar dhe e ka asgjësuar kamerën e vëzhgimit e cila ishte e vendosur në shtyllën elektrike afër depos së market “Sh.” në fshatin K., Komuna G., me ç’ rast të dëmtuarit ju ka shkaktuar dëm në vlerë prej 120 Euro.-

-me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 4; 7; 17; 21; 41; 42; 43; 46; 49; 50; 51; 52; 62; 69; 73; 74; 75; 76 dhe 80 dhe në bazë të neneve 248; 359; 365 dhe 366 të KPPK-së të akuzuarin e :

G j y k o n:

- Për veprën penale si në dispozitivin e I-rë të këtij aktgjykimi, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumë prej dyqind e pesëdhjetë euro (250 €) dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj,

- Për veprën penale si në dispozitivin e II-të, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj,

Andaj Gjykata në bazë të nenit 80 par.1 të KPRK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM UNIK ME KUSHT

- Dënim me gjobë në shumë prej dyqindpesëdhjetë Euro (250 €), të cilën gjobë mund ta paguaj me këste (dy këste), në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;
- Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar dhe nëse e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo njëzet euro (20 €) do të llogaritet një ditë burg dhe
- Dënim Unik me kusht, ashtu që i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej dy (2) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe

DËNIMIN PLOTËSUES:

- Konfiskohen: një armë e punuar artizanat, 28 copë, fishek të calibrut 16 mm, 5 copë fishek të armës automatike 7.62 mm, 1 copë fishek i pushkës M 48 dhe 1 fishek i armës me gaz.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën aq sa do të llogaritet sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje të përmbarimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që palës së dëmtuar, Z. H., t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 120 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.17/16 të datës 12.08.2016, kundër të akuzuarit B. I., për shkak të dy veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 25.04.2017, ku prezantuan Prokurori i shtetit, Arian Gashi dhe i akuzuari B. I..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari B. I., deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe se e ndien vetën fajtor për të dy veprat penale, këtë pranim të fajësisë e bëri me vullnet të plotë pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, se dëmin e shkaktuar, nuk e ka bërë me ndonjë qëllim të caktuar, me palën e dëmtuar janë pajtuar, është penduar shumë, për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin dhe kërkoi nga gjykata mundësisht t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë pasi që jeton në kushte të vështira ekonomike dhe premtoi para gjykatës se më nuk do të përsërisë vepra penale të tilla apo të ngjashme.

Prokurori i shtetit Arian Gashi, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuar deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari B. I., andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin pranim ta aprovojë dhe të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa si rrethana lehtësuese të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pendimin e tij për veprat e kryera penale.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet nga Prokuroria e shtetit dhe pas marrjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga prokurori i shtetit, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të dy veprat penale për të cilat akuzohet, Gjykata nuk administroj prova por vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit B. I., formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform neni 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: i akuzuari e pranoi fajësinë për veprat penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, se është penduar për veprat penale, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, ka shprehur keqardhje dhe pendim dhe ka premtuar se më nuk do të përsërisë vepra penale, se me palën e dëmtuar janë pajtuar, ndërsa rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj nisur nga të gjitha këto rrethana, gjykata të akuzuarit duke i aplikuar edhe dispozitatat për zbutjen e dënimit i shqiptoj dënimin me gjobë dhe me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas neni 73.par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas neni 41 dhe 50 të KPRK-së.

Dënimi i shqiptuar me kusht, është risocializim i të akuzuarit me anë të pezullimit të dënimit. Me anë të këtij dënimi kryesit i tërhiqet vërejtja seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale dënimi i suspenduar për një kohë të caktuar do të ekzekutohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të neni 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe 453 par 1 të KPPK-së.

Vendimi për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar, është marrë në bazë të neni 458 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të neni 62 par. 1 dhe 2 pika 2.7 dhe 69 si dhe neni 375 par.3 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 473/16 dt.25.04.2017.**

Procesmbajtësja
Arbnore Idrizi

Kryetarja e trupit gjykues
Valbona Musliu-Selimaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.